



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:263377
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05616272

KPPP.nr.1893/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.T. “NUKA”, me NUI: 810024612, me seli në rr. “Mbretëresha Teutë” nr.22, të cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokatisë “ICS ASSISTANCE”, me seli në Prishtinë, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”, me seli në rr. “2 Korriku” Nr. 4, në Prishtinë, duke vendosur sipas parashtresës së kreditorit për Urdhrin Përmbartimor P.nr.858/19 të datës 27.11.2019, jashtë seancës me datën 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbartimit e lejuar sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.858/19 të datës 27.11.2019, të Përmbartuesit Privat Eset Murati me seli në Prishtinë, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P.T. “NUKA”, kundër debitorit Kompania e Sigurimeve “EUROSIG”, për shkak të tërheqjes së propozimit për përmbartim nga ana e kreditorit.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Eset Murati, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P.T. “NUKA”, me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.858/19 me datën 27.11.2019, duke lejuar përmbartimin në bazë të titulli ekzekutiv Aktgjykimit Ae.nr. 142/2017 të datës 02.10.2019 dhe Aktgjykimit III.EK.nr. 196/2013 të datës 24.04.2017, ku meqenëse debitori ka dështuar që vullnetarisht të ekzekutoj detyrimin e tij nga Aktgjykimi III.EK.nr. 196/2013 të datës 24.04.2017, të caktohet përmbartimi për pagesën e shumave si në vijim: 135,311.33 € në emër të borxhit kryesor, respektivisht shpërblimit të dëmit, me kamatë vjetore prej 8% në vit,

duke filluar prej datës 03.01.2013 e deri në datën e përllogaritjes nga eksperti financiar, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore në shumën prej 6,556.75 €, si dhe në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim në shumën prej 624.00 €.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, debitori me datën 11.12.2019 ka paraqitur prapësim, ndërsa kreditori me datë 19.12.2019 ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori me datën 26.05.2021 ka dorëzuar parashtresën për tërheqjen e propozimit për përmbarim, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr.2133/19 të datës 22.02.2021 e ka aprovuar prapësimin e debitorit si të bazuar dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.858/19 të datës 27.11.2019 të përmbaruesit privat Eset Murati.

Ndaj vendimit të lartcekur i cili është pranuar nga ana e kreditorit me datën 14.02.2022, kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe procedurës kontestimore, duke theksuar ndër të tjera se në rastin konkret Gjykata e Shkallës së parë, nuk ka marr për bazë fare kërkesën e debitorit për tërheqje nga propozimi për përmbarim.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.691/2023 të datës 06.11.2023 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin PPP.nr. 2133/19 të datës 22.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, e cila lëndë ka marr numrin e ri KPPP.nr. 1893/23.

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, në rivendosje, pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe duke u bazuar në vërejtje e dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, ka shqyrtuar edhe parashtresën e kreditorit të paraqitur me datën 26.05.2021, nga e cila rezulton se kreditori ka bërë tërheqjen e propozimit për përmbarim të lejuar sipas Urdhrin Përmbarimor P.nr.858/19 të datës 27.11.2019 të përmbaruesit privat Eset Murati.

Andaj Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 42 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore me të cilin përcaktohet se: *“Propozimi për përmbarim mund të*

tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbare pa pëlqimin e debitorit” dhe par. 2 të po këtij neni i cili përcakton se: “ Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbare organi përmbare e përfundon përmbaremin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht “, duke vepruar sipas parashtrësës së kreditorit të datës 26.05.2021, këtë çështje përmbare e përfundoi në tërësi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Duke bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 42 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1893/23, datë 24.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimt të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.